

UDHËZIM
Nr. 13, datë 9.4.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.5.2010 “PËR
ADMINISTRIMIN DHE DOKUMENTIMIN E PROCEDURAVE TË PAJISJEVE
FISKALE”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të neneve 55 dhe 56 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 16, datë 3.5.2010 “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 9.1 “Lidhja e dispenserave të karburantit me pajisjen fiskale”, shkronja “c”, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“c. Puna e dispenserit ku është instaluar pajisja fiskale bëhet nën kontrollin KDE, të lidhur sipas skemës dispenser-KDE-pajisje fiskale:

- Dispenseri duhet të punojë vetëm në regjimin automatik, nën kontrollin e sistemit fiskal, me saktë KDE. KDE-ja komunikon me dispenserin sipas protokollit të caktuar, mban të memorizuar numërorin progresiv të dispenserit, duke e freskuar atë pas çdo shitjeje. KDE-ja vuloset në të njëjtat kushte si pajisja fiskale nga tekniku i autorizuar.

- Dispenseri nuk do të vazhdojë të veprojë edhe kur pajisja fiskale pëson defekt të karakterit elektrik apo ndërprerje komunikimi me KDE-në. Derisa dëmtimi të rregullohet, dispenseri duhet të bllokohet, të mos livrojë më lëng.

- Riparimi i pajisjes fiskale duhet të kryhet menjëherë nga shoqëria e autorizuar me të cilën tatimpaguesi ka kontratë mirëmbajtjeje.

- Në rast se shpëputet lidhja midis KDE-së dhe qarkut elektronik të dispenserit, si dhe pajisjes fiskale, dispenseri bllokohet menjëherë.

- KDE-ja kalkulon dhe verifikon vlerat absolute të numërorit pas rilidhjes me numrat e regjistruar në memorien e saj para defektit dhe e dërgon këtë informacion në pajisjen fiskale, duke e printuar automatikisht kuponin tatimor me çmimin e tabelës.

- Tekniku i shoqërisë së autorizuar duhet të paraqesë në librin e mirëmbajtjes të gjitha të dhënat e defektit (data/ora kur filloi dhe mbaroi defekti, si dhe përshkrimi i defektit).

- Në rast mbarimi të letres ose koka e printerit të pajisjes fiskale është e hapur, dispenseri nuk duhet të veprojë.

2. Titulli i pikës 10.1 “Raporti tatimor ditor “Z” në raste pa defekte” zëvendësohet me këtë përmbajtje “10.1 Raporti tatimor ditor “Z””.

3. Pika 10.2 “Raporti tatimor ditor “Z” në rast defekti” shfuqizohet.

4. Në pikën 12.1 “Lidhja e kalimatësve me pajisjen fiskale”, shkronjat “c” ndryshon me këtë përmbajtje:

“c) Dispenseri nuk duhet të vazhdojë të veprojë edhe kur pajisja fiskale pëson difekt të karakterit elektrik apo ndërprerje komunikimi me KDE-në, derisa dëmtimi të rregullohet, dispenseri duhet të bllokohet, të mos livrojë më lëng”.

5. Në pikën 12.1, shkronja “d” ndryshon me këtë përmbajtje:

“d) Menjëherë pas rilidhjes së dispenserit me KDE-në dhe vënies në punë të pajisjes fiskale nën regjimin automatik, KDE verifikon vlerat absolute të numërorit, pas rilidhjes, me numrat e regjistruar në

memorien e saj pas difektit dhe e dërgon këtë informacion në pajisjen fiskale, duke printuar automatikisht kuponin tatimor me çmimin e tabelës. KDE-ja mban të memorizuar numërorin progresiv të kalimatësit, duke e regjistruar atë pas çdo shitjeje”.

6. Në pikën 13. 1 bëhet ky ndryshim: “Raporti tatimor “Z”.

7. Pika 13.2 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani